



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	80/18
Nr. i fq. / Br. st	- 2 -
Data: / Datum	29. 03. 2018
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 06 MARS 2018**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:00.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Bastri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtirm Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Ymer Haradinaj.

Munguan: Ali Januzi, Gresa Muli, Lutfi Bilalli, Teuta Aruçi – Shartari dhe Miljan Bojković.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri, përfaqësuesi i Akademisë Policore në Vushtrri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Para hapjes së mbledhjes u intonua Himni Kombëtar dhe Himni Shtetëror i Republikës së Kosovës.

R E N D I T E

1. Shënimi i "Epopesë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", 20 vjetorit të rënies heroike të Komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari, dëshmorëve të kombit dhe të gjithë të rënëve për liri.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë - pasi hapi mbledhjen tha se jemi mbledhur në këtë mbledhje solemne të kuvendit të komunës, e cila është përcaktuar me agjendën e Qeverisë të Republikës së Kosovës, për nder të shënimit të 20-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, gjegjësisht rënies heroike të Komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij.

Konform nenit 10 të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me të cilën rregullohet mbajtja e mbledhjeve solemne po e hapim takimin e sotëm dhe pastaj fjalën ia kaloi kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë:

Të nderuar anëtar të kuvendit,
I nderuar nënkryetar i komunës z. Besim Muzaqi,
Të dashur qytetarë të Vushtrrisë,
Të nderuara familje të dëshmorëve të lirisë,
Të nderuar veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar veprimtarë të lëvizjes për liri e pavarësi të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Sot të gjithë ne jemi mbledhur në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës për të kujtuar dhe nderuar Komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari dhe sakrificën e madhe të familjes Jashari për liri dhe pavarësi. Këtu e 20 vite më parë, më 5, 6 dhe 7 Mars 1998, në Prekaz të Drenicës u zhvillua një nga betejat më të lavdishme të popullit tonë për liri. Kjo betejë udhëhiqej nga Ademi, Hamza, Shabani dhe u ndihmua nga secili anëtar i familjes Jashari deri në fljimin e tyre. Kështu në këtë betejë u vranë 53 anëtarë të familjes Jashari, prej tyre 21 anëtarë të familjes së Adem Jasharit e nga ta 10 ishin fëmijë. Kjo ishte një betejë e pabarabartë në çdo aspekt të saj, ishte e pabarabartë për nga armatimi e municioni që përdorej në këtë betejë, ndërsa ishte e pakrahasueshme për nga qëllimi që synohej të arrihej. Në njërën anë një familje luftonte për të mbrojtur pragun e shtëpisë, për të rimëkëmbur dinjitetin njerëzor të një populli të tërë e në anën tjetër një ushtri e polici synonte të mbante të robëruar një familje, një popull të tërë.

Familja Jashari, Komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari, me sakrificën e tyre, shkruan rrëfimin më të mirë se qysh duhet atdheu. Familja Jashari është vetë historia e lirisë së Kosovës dhe na shërben si frymëzim e mësim për ne e për gjeneratat e reja se sa e çmueshme është liria. Ata, dëshmorët sot janë të gjallë, por gjallërinë e tyre ne nuk arrijmë ta kuptojmë. Adem Jashari, Shabani, Hamza e Kushtimi janë heronjtë e mi, janë heronjtë e fëmijëve të mi dhe do të jenë heronjtë e gjeneratave që do të vijnë, të çdo vajze e djali që nënat tona do të lindin në këtë truall të bekuar nga vet Zoti.

Ne e kemi për obligim që të bëjmë shtetin tonë të fuqishëm, të drejtë e prosperuar për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për gjeneratat që do të vijnë pas nesh. Sfidat i kemi të mëdha, ndonjëherë edhe nuk kemi qenë në lartësinë e detyrës që ka kërkuar atdheu, por Bacë, sot jam i bindur më shumë se kurrë që Kosova për të cilën ju e dëshmorët dhatë jetën, do të jetë vend ashtu si ju e ëndërruat, e lirë dhe sovranë, ku fëmijët tanë do të rriten si gjithë fëmijët e botës. Lavdi!


Mbledhja përfundoi në ora 10:13.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

